



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

**BORDI**

---

**KODI I ETIKËS SË AKTUARËVE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 15, datë 26.02.2016*

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Ky Kod hartohet në zbatim të pikës 11, të nenit 222, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

**Neni 2**

**Qëllimi dhe fusha e veprimit**

(1) Qëllimi i këtij Kodi është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për aktuarët, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fushat që ushtrojnë veprimtarinë.

(2) Ky Kod përmban rregulla dhe parime të cilat aktuarët duhet t’i zbatojnë gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre, me qëllim ndërtimin dhe promovimin e besueshmërisë në punën e tyre në kuadër të interesit publik si dhe mbrojtjen e interesave të shoqërisë së sigurimit.

### Neni 3

#### Përkufizime

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“**Kod**” do të nënkuptohen Kodi i Etikës së Aktuarëve.

“**Aktuar i autorizuar**” është personi i licencuar nga Autoriteti, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 52/2014 cili, ndër të tjera, ka si detyrë kryesore llogaritjen e tarifave të primeve, tabelave të probabilitetit, provigjoneve dhe dividendeve duke u mbështetur në teori shkencore që lidhen me investimet, statistikën, matematikën, financën dhe demografinë.

“**Shërbime aktuariale**” janë shërbimet profesionale që i ofrohen shoqërisë së sigurimit nga një individ, i cili vepron si aktuar i licencuar. Këto shërbime mund të përfshijnë, llogaritjet, këshillime, rekomandime, gjetje apo/ose opinione të bazuara në vlerësime aktuariale.

“**Informacion Konfidencial**” nënkupton çdo të dhënë, fakt apo rrethanë/informacion me të cilin aktuari vihet në dijeni për shkak të ofrimit të shërbimeve aktuariale, të cilat janë të ndaluar me ligj të qarkullojnë.

### Neni 4

#### Parimet e Përgjithshme

(1) Bazuar në procesin e punës së aktuarëve, është shumë e rëndësishme që aktiviteti i tyre të ndërmerret në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme për të nxitur besimin tek shoqëria e sigurimit.

(2) Aktuarët duhet të përmbushin kërkesat ligjore dhe profesionale lidhur me:

- a) Përshtatshmërinë e njohurive dhe të kompetencave;
- b) Ushtrimin e veprimtarisë me përgjegjshmëri dhe integritet;
- c) Respektimin e kërkesave ligjore dhe etike për konfidencialitetin dhe ruajtjen e informacionit;
- d) Ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga faktore të tjerë, duke përfshirë edhe konfliktin e interesit.

### Neni 5

#### Njohuritë dhe kompetencat

(1) Aktuarët duhet të synojnë përmirësimin dhe thellimin e njohurive të tyre në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale për përmirësimin e shërbimit ndaj shoqërisë së sigurimit.

(2) Aktuarët duhet të kryejnë detyrën me përkushtim, ndershmëri, dhe përgjegjësi, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pjesëmarrja në aktivitete e veprimtari profesionale të cilat synojnë rritjen e njohurive, aftësive dhe kapaciteteve profesionale është mjaft e rëndësishme.

(3) Aktuarët i nënshtrohen vlerësimit periodik të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Aftësitë dhe eksperiencat profesionale të përfituara duhet të vihen në funksion të zbatimit të detyrave dhe përmirësimit të cilësisë së punës.

## **Neni 6**

### **Përgjegjshmëria dhe integriteti**

(1) Aktuarët duhet të reflektojnë standarde të larta të integritetit personal e profesional gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duke zbatuar detyrat e parashikuara në kuadrin ligjor përkatës në mënyrë transparente, të përgjegjshme dhe korrekte.

(2) Aktuarët nuk do të ofrojnë shërbim ndaj shoqërisë së sigurimit nëqoftëse ka arsye të besojnë se të dhënat e ofruara nga ky i fundit mund të përdoren për të shkelur ose shmangur ligjin.

(3) Aktuarët nuk do të angazhohen në asnjë veprimtari të pandershme, mashtruese ose shtrembëruese ose të kryejnë ndonjë akt që reflekton negativisht në shërbimin/et aktuariale.

## **Neni 7**

### **Ruajtja e informacionit dhe konfidencialiteti**

(1) Çdo aktuar i cili vihet në dijeni të të dhënave personale dhe konfidenciale të klientëve dhe të shoqërisë së sigurimit duhet t'i përdori ato vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave.

(2) Aktuarët nuk duhet të bëjnë publik informacionin e marrë për shkak të ushtrimit të profesionit, pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur kanë detyrim ligjor për ta bërë atë. Ata duhet të ruajnë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës dhe nuk duhet ta përdorin atë për përfitim personal dhe në kundërshtim me ligjin.

## **Neni 8**

### **Konflikti i interesit dhe pavarësia**

(1) Aktuarët duhet të njohin dhe zbatojnë me korrektësi detyrimet e kuadrit ligjor që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrave të tyre. Aktuarët kanë detyrim të plotësojnë me shkrim deklaratën e konfliktit të interesit sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(2) Aktuarët duhet të jenë profesionalisht të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre dhe duhet të garantojnë që aktiviteti që ata kryejnë nuk bie ndesh me interesat e shoqërisë së sigurimit. Aktuarët duhet të ndalojnë angazhimin nëse një konflikt interesi cënon ushtrimin e veprimtarisë së tyre me profesionalizëm dhe integritet.

## **Neni 9**

### **Marrëdhëniet me Shoqërinë e Sigurimit**

Aktuarët duhet të zbatojnë vetëm kriteret profesionale në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, si e vetmja mënyrë për t'i shërbyer interesave më të mira të palëve që përfshihen në një veprimtari sigurimi. Aktuarët duhet t'i shpjegojnë shoqërisë së sigurimit me thjeshtësi dhe qartësi, elementët thelbësore dhe risqet e mundshme të lidhura me ushtrimin e shërbimeve aktuariale.

## **Neni 10**

### **Masat disiplinore**

Aktuarët të cilët kryejnë shkelje materiale të dispozitave të këtij Kodi i nënshtrohen procedurave dhe masave disiplinore të parashikura në aktet ligjore e nënligjore në fushën e sigurimeve

## **Neni 11**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Kod hyn në fuqi menjëherë.